



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina

Njoftim Publik

Në drejtorinë e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës është dorëzuar aplikacioni **05 nr.350/02 – 169885/21 dt.18.08.2021**, në emër të pronarëve: Jusuf Ulaj, Selime Simnica, Agron Zeqiri, Fisnik Koçinaj, Fatmir Maloku, Luljeta Bytyqi, Pëllumb Bajgora dhe Ujup & Samir Rexha nga Prishtina dhe Investitori "Krapu Com" sh.p.k. nga Prishtina me certifikatë të biznesit ARBK nr.810196578, me përfaqësues Faik Krapu, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimore / projektin kryesor për ndërtimin e Kompleksit "Capitol Residence" me ndërtesa shumë banesore & afariste – Objekti "4" me B+P+5 & "5" me B+P+5 në kuadër të Bllokut urban "B-6", Tërësia "B" të Ndryshimi dhe Plotësimi i Planit Rregullues "Arbëria 3" në Prishtinë, konkretisht parcelave: nr.7177-12, 7177-21, 7177-22, 7177-23, 7177-24, 7177-25, 7177-30, 7177-65, 7177-66, 7177-67, 7177-68, 7177-69 & 7177-70 ZK Prishtinë, sipas projekt propozimit / Planit të situacionit - "zgjidhjes urbane" të prezantuar.

Me aplikacion është prezantuar edhe projekt propozimi për ndërtimin e kompleksit të lartcekur. Bazuar në pikën 2 të nënit 18 të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, "Organi kompetent njofton publikun dhe mundëson komentet për kërkesën e dhënies së lejes së ndërtimit". Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data **08.11.2021** deri me datën **22.11.2021** në Email adresën: urbanizmi@prishtine.gov.net

Kushtet e propozuara: Kompleksit "Capitol Residence" me ndërtesa shumë banesore & afariste – Objekti "4" me B+P+5 & Objekti "5" me B+P+5

a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Tokë bujqësor / "Arë e Klasës 3" – Tokë ndërtimore
b. Vija rregulluese	0.00m' Sipas Planit rregullues "Arbëria 3"
c. Vija ndërtimore	7.00m' Sipas Planit rregullues "Mati 1"
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	7.0m' /19.20m'
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	Anësor: 8.8/16.20m' Pasmë : 7.6m'/13.20m' & 9.60m'/16.20m'
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	30% ose 970m ² sip. ndërtimore e shputës
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	Koeficienti 1.5 – 6464m ² , sipërfaqe ndërtimore mbi tokë
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	40%- sipas PRRU "Arbëria 3" e lejuar,
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	60% - ose 1050m ² i lejuar dhe propozuar
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	56VP, nën tokë & 30VP, mbi tokë
k. E drejta e ndriçimit natyror për ditaret ekzistuese	Po

- l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - Jo - Nuk aplikohet -
- m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - Jo - Nuk aplikohet - Sqaro:
- n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - Jo - Nuk aplikohet - Sqaro:

Në bazë të Udhëzimit administrativ 06/2017, dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i përpunimit të komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqen e Komunës.

Në të gjitha komentet tuaja duhet të përshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë.

Nënshkrimi i Zyrtarit:

